

STATUTI
I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Kapitalx_AL” SH.P.K

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Sot, me date 01.06.2025 (dymije e njezet e pese) te nenshkruarit:

Ortaku Kapital X SHPK, e themeluar me 15 janar 2013 ne Prishtine Republika e Kosoves,
me nr unik 810 822 719. Me adrese 10000 Prishtine Rr Holger Pedersen 1/7 republika e
Kosoves

3. **Ortaku Ervis Jaho** i biri i Qetësorit dhe Drita i dtl 24.05.1985, lindur në Kolonjë banues
në Tiranë Rr “Besim Memaci”, banesë private Tiranë identifikuar me ID nr I50524055Q.

Si themelues te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar, vendosem te miratojme statutin e
shoqerise private **“Kapitalx_AL” SH.P.K** si vijon, mbështetur në parimet e mëposhtme:

KREU II
EMRI, STATUSI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 2

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar **“Kapitalx_AL” SH.P.K** me themelues Partneri A dhe
Partneri B


Neni 3

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaket do të
përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nënshkuara për
kapitalin.

Neni 4

Selia e shoqerise **“Kapitalx_AL” SH.P.K** do te jete ne adresen: Rr ‘Shefqet Ndroqi’, nr 11/13
Tiranë.

Neni 5



Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

KREU III
O B J E K T I

Neni 6

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Punime në fushën e ndertimeve dhe projekteve, ndertime objekte banimi dhe jobanimi, ndertim i rrugëve dhe autostradave, ndertimi i hekurudhës mbi dhe nëntokësore, ndertimi i urave dhe tuneleve, hartimi i projekteve të tubacioneve dhe kanalizimeve, hartimi i projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikacion, hartimi i projekteve të ujit, hartimi i projekteve të tjera të ndërtimit civil, demolimi i objekteve, instalime elektrike, punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit, instalime të tjera ndërtimore, punime suvatimi, punime montimi druri dhe materialeve të tjera, punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve, punime lysterje dhe vendosje xhamamsh, përfundim dhe finalizimin e punëve të tjera të ndërtësive, punimet të çatise, aktivitete të tjera të specializuara në ndërtim, ndërmjetësim për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve të tjera të ndërtimit, ndërmjetësim për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash, tregëti me shumicë e drurit, materialet të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare, tregëti me shumicë e pjesëve elektronike, pajisje hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit, tregëti me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme, blerja dhe shitja e pasurive të patundshme, Qiradhenia dhe menaxhimi i pasurive të patundshme personale ose të marra me qera, administrimi i ndërmarrjeve për të treta, aktivitete të arkitektures, aktivitet të inxhinierisë dhe keshillimit teknik.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Ortakëve të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITALI

Neni 7

Kapitali fillestar i shoqërisë private **"Kapitalx_AL" SH.P.K** do të jetë 100.000 (njëqindë mijë) lekë, si vijon:

Emri	Përqindja	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Shoqëria Kapitalx sh.p.k	51%	1	51.000 lekë
Ervis Jaho	49%	1	49.000 lekë



Kapitali themeltar është nënshkruar krejtësisht nga ortakët themelues dhe pjesa në vlerë do të depozitohet në llogarinë e posaçme të shoqërisë mbas fitimit të personalitetit të saj dhe hapjes së llogarisë në bankë në emër të saj.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

Neni 8

Ortaku që ka ndërmend të shesë kuotat e tij, tërësisht apo pjesërisht duhet më parë të njoftojë ortakun/ortaket e tjerë të shoqërisë. Ortaku/Ortakët e tjerë kanë të drejtën e blerjes së pare. Këtë të drejtë ortakët duhet ta ushtrojnë brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Në rastin e mosushtimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e bleresit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se ato të ofruara ortakëve të tjerë të shoqërisë.

Neni 9

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri të lujtshme ose të palujtshme etj, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

Neni 10

Heqja dorë e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet që kanë lindur në shoqëri para se ai të largohet. Po kështu ai fiton dhe të drejtat që janë krijuar para largimit të tij.

Neni 11

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve, në proporcion me përqindjet e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të kalojë kuotat e përcaktuara në kapitalin fillestar. Rritja e kapitalit nga ortakët do të bëhet vetëm me vendim unanim të Asamblese së ortakëve.

Shoqëria **“Kapitalx_AL” SH.P.K** është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Në Republikën e Shqipërisë, shoqëria **“Kapitalx_AL” SH.P.K** gëzon të drejtë sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 12

Shoqëria "Kapitalx_AL" SH.P.K vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaket themelues të shoqërisë mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortaket kanë patur para se ajo të krijohet.

KREU IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Përgjithshme

Administratori **Ervis Jaho** për një periudhë 5 vjetore. Duke filluar nga data 01.06.2025 deri më 31.05.2030 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 14

KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Miraton ndarjen e fitimeve dhe dividendëve;
- j) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15

MBLEDHJA E ASAMBLESË

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose ortakët e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Neni 16

THIRRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 13 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën dhe orën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Procesverbalit i bashkangjitet dhe lista e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të Procesverbaleve.

Mbledhja e Asamblesë kryesohet nga Administratori i shoqërisë.

Neni 17

Shoqeria private “**Kapitalx_AL**” SH.P.K, përfaqësohet nga administratori i saj **Ervis Jaho** për një periudhë 5 vjecare.

KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme emëron Administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit të tij është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare në të gjitha marrëdhëniet tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e organizimit të shoqërisë;
- marrë dhe shkarkojë nga puna personelin dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme në interes të shoqërisë;

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

KREU V

PRISHJA E SHOQËRISË



Neni 18

Shoqëria **"Kapitalx_AL"** SH.P.K, prishet:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse shoqëria nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
- ç) me vendim të gjykatës;

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likuidimit emrit te shoqerise i shtohet pjesa "Ne likujdim" qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqeria nxjerr gjate kesaj periudhe.

Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Pergjitheshme, kerkon çregjistrimin e shoqerise prane QKB, pas shperndarjes se aktiveve te mbetura te shoqerise.

VITI FINANCIAR

Neni 19

Ne perputhje me ligjin shoqeria do te kete nje regjister ne te cilen mbahen balance vjetore, raporte financiare vjetore dhe cdo kerkese tjeter ligjore.

Neni 20

Viti financiar i shoqerise fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 Dhjetor te po ketij viti, me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon ne 31 Dhjetor.

FITIMET

Neni 21

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si fitim, bazuar ne kuotat qe zoteron cdo ortak.

PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

Neni 22

NENSHKRIMI I KAPITALIT TE ORTAKËVE

Kapitali themeltar nenshkruset dhe ekzekutohet ne perputhje me kuotat si me poshte:

Emri	Perqindja	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Shoqëria Kapitalx sh.p.k	51%	1	51.000 lekë
Ervis Jaho	49%	1	49.000 lekë

Kapitali i neneshkruar i shoqërise do të depozitohet në llogarinë e posaçme të shoqërise mbas fitimit të personalitetit të saj dhe hapjes së llogarise në banke në emër të saj.

Neni 23

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij Statuti, dhe Aktit të Themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare e Biznesit (QKB), Tiranë. Regjistrimi i kësaj Shoqërie në QKB do të bëhet nga Administratori.

Shoqëria ka vulën e vetë në të cilën shkruhet emri i shoqërisë sic e prashikon ligji.

Për ato që nuk janë parashikuar në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Për lajmërimet e njoftimeve :

- shoqëria do të ketë këtë adresë elektronike: Kapitalx3@gmail.com dhe nr telefoni +355 69 338 7848 dhe +383 49 340 800 që do të përdoret nga administratori.
- Ortaku shoqëria Kapitalx sh.p.k do të ketë këtë adresë: Rr. 10000, Prishtinë Rr "Holger Pedersen", 1/7, Republika e Kosovës
- Ortaku Ervis Jaho do të ketë këtë adresë Tiranë Rr "Besim Memaci":
- Çdo ndryshim i adresës si më sipër do të njoftohet zyrtarisht shoqërisë dhe do të pasqyrohet edhe në QKB.

Ky statut përpilohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe me vlerë të njëjtë për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërise private "Kapitalx_AL." SH.P.K

ORTAKET THEMELUES

"Kapitalx_AL" SH.P.K

Ervis Jaho

Shoqëria Kapitalx sh.p.k

Administratori Valdet Xoxa

